



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo



Qeveria - Vlada - Government
Komuna/ Opstina/ Municipality Drenas (Glllogoc)
Drejtoria për Shëndetësi e Mirëqenje Sociale

Nr. CG. 40028757 Dt. 28.05.2019

THIRRJE PUBLIKE PËR APLIKIM

Për ofrimin e mbështetjes financiare të interesit publike për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve dhe personave fizik për fushën e Mirëqenjes e përkujdesjes sociale, të cilat ofrojnë shërbime sociale e familjare të kategorive me kërkesa të veçanta

1. Komuna e Drenasit u bënë thirrje publike të gjitha organizatave joqeveritare (OJQ), të regjistruara, si dhe personave fizik, programi i punës i të cilave është i fokusuar në fushën e mirëqenjes sociale, për zbatimin e projekteve dhe zhvillimin e aktiviteteve avokuese, këshilluese dhe ofrimin e drejtëpërdrejtë të shërbimeve sociale dhe familjare. të aplikojnë për mbështetjen financiare për zbatimin e projektit të promovimit dhe zhvillimit të kulturës, sportit dhe edukimit të rinisë.

2. OJQ-të dhe personat fizik në përputhje me këtë Thirrje publike mund të aplikojnë me projektet/programet e tyre për aktivitetet e mëposhtme, por duke mos u kufizuar vetëm në këtë:

- Shërbime mbështetëse dhe këshilluese për të gjitha kategoritë: e personave me aftësi të kufizuara;
- Shërbime mbështetëse, sensibilizim dhe pjesëmarrje në aktivitete të ndryshme rekreative për pensionistë dhe persona të moshuar.

3. OJQ-ja ose individi mund të paraqesë vetëm një projekt në kuadër të aktiviteteve të lartëshenuara e që do të përfshijë dhe kontribuojë në shërbime sociale e aktivitete të paraparë me pikën 2 të kësaj Thirrjeje publike. Nuk mund të paraqitet një projekt i cili do të përmbajë aktivitetet nga të dy fushat, por ekskluzivisht ndaras për secilën fushë.

4. Vlera e përgjithshme e planifikuar e Thirrjes publike është 11,500.00€ (njëmbëdhjetë mijë e pesqind euro), nga e cila:

- Nën a. 11,000.00 €
- Nën b. 500.00 €

Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për çdo projekt individual është 200.00€, ndërsa shuma maksimale për një projekt është 10,000.00€.

5. Afati i fundit për dorëzimin e propozimit është 15 ditë pune nga dita e publikimit të Thirrjes publike, përkatësisht dita e fillimit është 28.05.2019, ndërsa dita e fundit për dorëzimin e

propozimit, projektit/programit, është 18.06.2019, nga ora 8:00 deri 16:00 në sportelet e pranimit të dokumentacionit për qytetarë, në objektin e Komunës së Drenasit.

6. Të drejtë aplikimi kanë OJQ-të që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave joqeveritare të R.Kosovës, me seli në territorin e Komunës së Drenasit dhe të cilat veprojnë dhe janë të regjistruara së paku një vit para datës së publikimit të Thirrjes publike, si dhe personat fizik banorë të Komunës së Drenasit.


OJQ-ja aplikuese duhet të paraqesë dëshmi se gjatë një viti është marrë me organizimin e ngjarjeve –shërbimeve sociale, si dhe nëse ka qenë përfituese e mjeteve financiare të ndara nga Komuna e Drenasit si dhe të njëjtat mjete i ka justifikuar duke paraqitur raportin financiar.

Pas nënshkrimit të kontratës, OJQ duhet të paraqesë prova se personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale, si dhe prova se OJQ-ja ka zgjidhur çdo çështje të hapur rreth pagesës së kontributeve dhe tatimeve të papaguara.

7. Propozimet do të dorëzohen vetëm në kuadër të formularit të paraparë, të cilin së bashku me Udhëzimet për aplikantët, janë në dispozicion në faqen e internetit të *Komunës së Drenasit-kk.rks-gov.net/drenas*. Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen me postë ose personalisht në zarf të mbyllur, në adresën e mëposhtme: Komuna Drenas, rrugu “Xhevë dhe Fehmi Lladrovci” 13000 - Drenas.

Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve pastaj vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, resurset, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendari tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara në Udhëzimin për aplikuesit.

Do të konsiderohen vetëm propozimet që janë paraqitur brenda afatit për paraqitjen e aplikacioneve dhe në formë të përcaktuar me Thirrjen publike.


Drejtori i D.SH.M.S

Arsim Haxhiu